



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 791/1 Prot.

Tiranë, më 21.05.2024

V E N D I M

Nr. 144, Datë 21.05.2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 189, datë 26.09.2023, (shtuar me plotësim dokumentacioni me shkresën datë 29.06.2023 dhe e-mail-in datë 06.10.2023), e S.S, e përfaqësuar¹ nga P.S kundër Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”, “shtatzënisë²” dhe “çdo shkak tjetër³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në dokumentacionin e dërguar, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Punoj si specialiste finance në Bashkinë Shkodër dhe prej 15 vitesh si pedagoge me kohë të pjesshme në departamentin e financë-kontabilitetit pranë Fakultetit Ekonomik në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Në 15 vitet e punësimit si pedagoge e jashtme, kontratat janë nënshkruar në mënyrë automatike nga institucioni dhe nuk ka pasur asnjë vonesë në firmosjen e tyre nga drejtuesit e universitetit (përveç vitit të fundit). Në këto vite nuk kam pasur asnjë ankesë për punën e zhvilluar si pedagoge e jashtme dhe kam marrë vlerësime maksimale nga studentët dhe nga stafi akademik i departamentit të financë-kontabilitetit.

¹ Referuar Prokurës së Posaçme, nr. repertori 251, nr. koleksioni 61, datë 24.01.2023, të noteres B.Xh.T.

² Referuar dokumentit të lëshuar nga Qendra Shëndetësore nr. 4, Shkodër, rezulton se znj. S.S është e pajisur me raport për leje lindje (paralindje) nga data 14.11.2022 deri në datë 19.12.2022.

³ Për shkak të ankesës që ka paraqitur bashkëshorti i saj, z. P.S tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kundër Universitetit të Shkodrës me nr. 143, datë 20.09.2022, dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr. 95, datë 05.08.2019.

Në muajin nëntor 2022 është hapur thirrja për vende të lira në programin e doktoratës në Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” dhe pasi kam aplikuar, jam shpallur fituese me datë 12.01.2023. Pas shpalljes fituese dhe mbarimit të procedurës së ankimimit nga komisioni i ngritur në Fakultetin Ekonomik, jam regjistruar në sekretarinë mësimore (23.01.2023) duke bërë edhe pagesën e regjistrimit. Pasi jam regjistruar, me datë 25.01.2023, ka ardhur një email nga sekretaria mësimore duke njoftuar çregjistrimin e kandidatëve fitues sepse Rektorja e universitetit kishte urdhëruar ngritjen e një komisioni tjetër për shkak se në konkurs ishin përjashtuar 4 pedagog të brendshëm (nga fakultete të tjera) të cilët duhet të shpallehin fitues (komisioni drejtohej nga vetë rektorja). Komisioni i dytë ad hoc nuk ishte i bazuar në ligj, por ai gjithsesi hoqi 4 pedagogë të jashtëm nga lista fituese duke më shpallur përsëri fituese. Në këtë rast është përsëritur procesi i regjistrimit në sekretarinë mësimore dhe pas këtij procesi jemi pajisur edhe me numrin identifikues të studentit nga ana e RASH (numri VIM). Sipas legjislacionit të arsimit të lartë, vetëm komisioni i Fakultetit Ekonomik është përgjegjës për shqyrtimin e dosjeve dhe përcaktimin e fituesve.

Studentët që ishin hequr nga lista fituese janë ankuar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit e cila nuk ka kthyer përgjigje për një periudhë 8 mujore. Pas kësaj periudhe ka ardhur një grup kontrolli në të cilën përmenden disa shkaqe të cilat kanë cenuar procesin në tërësi të doktoratës dhe kushte që duhen plotësuar nga kandidatët.

Duke u bazuar në këtë raport, komisioni i doktoratës në Fakultetin Ekonomik është mbledhur përsëri në periudhën e pushimeve zyrtare dhe me datë 31.08.2023 ka dërguar një email ku njoftojnë çregjistrimin nga doktorata.

Në vendimin e dërguar nga komisioni i doktoratës pranë fakultetit, konsideron se shkak për ndërprerjen e ndjekjes së doktoratës është fakti se në muajin kur është mbajtur konkursi, unë nuk kam pasur të nënshkruar kontratën si pedagoge e jashtme dhe certifikata e gjuhës që unë kam pasur në momentin e konkursit nuk është sipas përcaktimeve të kritereve të miratuara nga MAS dhe publikuara në njoftimet zyrtare.

Interpretimi i kritereve sipas të cilave Komisioni i doktoratës ka vendosur përjashtimin është tërësisht diskriminues sepse:

1. Kriteri 2A është kriter preferencial dhe jo përjashtues sipas kritereve të miratuara nga njëzia bazë dhe nga MAS. Kriteri 2A përcakton se kanë prioritet kandidatët që kanë detyrimin ligjor të kualifikimit për shkak të punësimit si personel akademik në IAL dhe në institucione kërkimore. Në rastin e aplikantëve të doktoratës në listën fituese të publikuar me 12.01.2023 janë vetëm 20 të kualifikuar dhe të tjerët janë skualifikuar për mosplotësim kriteri. Ndërsa tek publikimi i komisionit me datë 31.08.2023 janë vetëm 10 fitues dhe pjesa tjetër është përjashtuar duke u bazuar në një kriter preferencial.

2. Pika 2A3 edhe pse preferenciale pranon punonjësit me kohë të pjesshme vetëm kur ato janë të punësuar me kohë të plotë në një institucion kërkimor. Në rastin e kandidatëve fitues të publikuar me vendimin e datës 31.08.2023 ka pedagog të jashtëm që janë shpallur fitues të cilët nuk janë pjesë e institucioneve kërkimore!

Këto kritere janë diskriminuese sepse unë kam aplikuar si pedagoge e jashtme me datë 30.09.2022 dhe jam shpallur fituese nga departamenti i financë-kontabilitetit në muajin tetor dhe më është propozuar e njëjta ngarkesë si vitin e kaluar akademik 2021-2022. Në këtë rast, rektorja e universitetit nuk ka firmosur disa kontrata të pedagogëve të jashtëm deri kur ka përfunduar procesi i aplikimeve të doktoratave vetëm për të favorizuar pedagogët e brendshëm në konkursin e doktoratës (ka pasur raste kur disa kontrata të pedagogëve të jashtëm janë firmosur duke sjellë selektivitet). Në muajin nëntor unë kam filluar lejen e lindjes të cilën e kam dërguar edhe në degën e burimeve njerëzore të universitetit duke pasur mundësinë e vazhimit të aktivizimit si pedagoge e jashtme në semestrin e dytë.

Në semestrin e dytë, nuk kam ndërprerë lejen e lindjes sepse ligji i arsimit të lartë lejon studentët e doktoratës në vitin e dytë të aktivizohen në mësimdhënie në mënyrë automatike. Procesi mësimor për pedagogë të jashtëm në vitin 2022-2023 nuk ka vazhduar derisa ka përfunduar procedura e shpalljes fituese të doktoratës. Kontratat e pedagogëve të jashtëm janë firmosur vetëm me datë 13.01.2023, një ditë pas dorëzimit të listave fituese nga komisioni i doktoratës në fakultetin ekonomik. Lejen e lindjes vazhdoj ta ushtroj edhe në ditët e sotme.

Përsa i përket certifikatës së gjuhës, unë zotëroj një certifikatë zyrtare e cila është lëshuar nga Universiteti i Tiranës dhe është pranuar fillimisht nga ana e komisionit të vlerësimit në fakultetin ekonomik. Vetë MAS me Udhëzimin nr. 10, datë 16.06.2023 ka ndryshuar kërkesat ligjore për pranimin në programin e doktoratës duke e ulur nivelin e kërkuar të gjuhës së huaj (nga CI në B2) dhe duke i kërkuar IAL të përcaktojnë në rregulloret e institucionit, nivelin e gjuhës së kërkuar. Universiteti i Shkodrës e ka të përcaktuar si kriter dalës dhe jo hyrës në program! Ky ndryshim nuk është marrë parasysh nga ana e komisionit ad hoc të ministrisë (raporti i kontrollit është para daljes së vendimit) dhe nga ana e komisionit të vlerësimit në muajin shtator 2023 (pasi ka shfuqizuar vendimin e datës 31.08.2023). Doktoratat zhvillohet në gjuhën Shqipe dhe jo në një ndër 5 gjuhët e kërkuara nga ana e Ministrisë.

Procesi i doktoratës ka qenë i ndërprerë për disa vite dhe çdo certifikatë e lëshuar nga institucione private ka një afat maksimal skadence. Në këto raste, universitetet e tjera publike kanë lejuar studentët që të marrin certifikatën e gjuhës deri në momentin e përfundimit të procesit mësimor.

Pas ankesës që kam paraqitur për diskriminim nuk është trajtuar sipas ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, dhe me datë 13.09.2023 është kthyer përgjigje negative nga ana e komisionit. Me datë 15.09.2023 ka ardhur grupi i kontrollit të MAS në fakultetin ekonomik për çështjen e doktoratave.

Me datë 18.09.2023, Rektorja e Universitetit ka dërguar një kërkesë sipas të cilës i kërkon komisionit të doktoratës që të rishqyrtojë vendimin e datës 13.09.2023 sepse nuk janë marrë në përputhje me rekomandimet e grupit të kontrollit të MAS. Pas kësaj, komisioni i doktoratës i fakultetit ekonomik ka marrë Vendimin nr. 18, datë 20.09.2023 duke revokuar vendimin e mëparshëm por duke ndryshuar vetëm frazën sipas të cilës vendimi nuk është marrë për shkak të grupit të kontrollit të MAS, por sipas vlerësimit të komisionit.

Vetë urdhri i Rektores për rishikimin e vendimit për shkak të mosplotësimit të rekomandimeve të raportit të MAS është i paligjshëm sepse nuk ka asnjë referencë për pika që nuk janë zbatuar dhe kjo tregon se është bërë vetëm me qëllim që të përjashtojnë pedagogët e jashtëm nga doktorata”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe lejimin për vazhdimin e doktoratës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 7 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkakun e pretenduar nga ankuesi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1048, datë 19.10.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjekti, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Kopje të plotë të shkresës nr. 1202, datë 05.10.2022 të Fakultetit Ekonomik dhe dokumenteve bashkëlidhur.
 - Kopje të shkresave nr. 3544/1, datë 16.11.2022, nr. 3544/2, datë 14.11.2022, nr. 3544/3, datë 14.11.2022 dhe nr. 3444/4, datë 14.11.2022.
 - Kopje të Vendimit nr. 38, datë 18.11.2022, “*Mbi konstituimin dhe miratimin e kryetarit të komisionit të dhënies së gradës shkencore Doktor në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm”*”.
 - Kopje të Vendimit nr. 263, datë 19.12.2022 “*Për krijimin e Komisionit të përherëshëm institucional për dhënien e gradës shkencore “Doktor”*”.
 - Kopje të shkresës nr. 63, datë 12.01.2023 të Fakultetit Ekonomik dhe dokumenteve bashkëlidhur.
 - Kopje të Vendimit nr. 4, datë 20.01.2023, Vendimit nr. 77, datë 13.03.2023 të dhënë nga Komisioni i përherëshëm institucional për dhënien e gradës shkencore “Doktor” dhe dokumenteve bashkëlidhur.
 - Kopje të Raportit përfundimtar të MAS me nr. 1397/7, datë 06.07.2023.
 - Kopje të shkresës së MAS nr. 3122/1, datë 21.08.2023.
 - Kopje të Vendimit nr. 13, datë 30.08.2023, Vendimit nr. 16, datë 13.09.2023, Vendimit nr. 18, datë 20.09.2023 të Fakultetit Ekonomik.
 - Kopje të ankesës për diskriminim të bërë nga S.S me shkresën nr. 1142, datë 06.09.2023 dhe të procedurës së ndjekur nga ana e Universitetit për trajtimin e kësaj ankese dhe përgjigjes së dhënë.
 - Informacion të plotë lidhur me procesin e përzgjedhjes dhe firmosjes së kontratave me pedagogë të jashtëm në Universitetin e Shkodrës dhe në veçanti në Fakultetin Ekonomik.
 - Informacion dhe kopje të kriterëve të pranimit në programin e doktoratës në fakultetet e tjera të Universitetit të Shkodrës.
 - Informacion nëse dhe në fakultete të tjera të universitetit ka ndodhur procesi i rivlerësimit të kandidatëve fitues në programin e doktoratës.

- Informacion nëse nuk janë shpallur fitues kandidatë për programin e doktoratës, për të njëjtat arsye si ankuesja (pa kontratë dhe niveli i gjuhës së huaj).
- Kopje të Rregullores për organizimin e programit të studimit të doktoratës të Universitetit të Shkodrës.
- Kopje të Statutit të Universitetit të Shkodrës.
- Kopje të Strategjisë së Universitetit të Shkodrës.
- Kopje të Vendimit të Senatit Akademik nr. 34, datë 23.01.2023.

Me shkresën me nr. 3238/2, datë 01.11.2023, Universiteti i Shkodrës, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Në lidhje me pretendimin e ankueses S.S për skualifikimin nga programi i doktoratës për shkak të mungesës së kontratës si pedagogë e jashtme si dhe certifikatës së gjuhës së huaj rezulton si më poshtë:*

Me Urdhër të MAS nr. 174, datë 04.04.2022 “Për hapjen e programit të Studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm” në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër është licencuar programi i ciklit të tretë, i sipërcituar.

Në vijim janë nënshkruar marrëveshje kuadër të grupimit të njësive bazë dhe të njësive kryesore në USH për bashkëpunim për realizimin e programit të ciklit të tretë të studimit, miratuar nga Rektori i Universitetit. Senati Akademik me Vendimin nr. 116, datë 31.05.2022 ka miratuar rregulloren “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratës ndërdisiplinore”.

Me shkresën nr. 1202, datë 05.10.2022 “Miratim i kriterëve të pranimit në programin “Doktoratë” në Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm” Fakulteti Ekonomik i universitetit ka dërguar pranë Rektorit kriteret e pranimit në këtë program. Në këtë shkresë Fakulteti Ekonomik ka përcaktuar rubrikat si më poshtë:

1. *Vendimin nr. 33, datë 05.10.2022 “Mbi miratimin e kriterëve të pranimit në programin “Doktoratë” në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm”.*
2. *Projektet kërkimore-shkencore dhe të zhvillimit për “Doktoratën” në Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm (shtojca 2).*
3. *Fushat dhe nënfushat e kërkimit shkencor në “Doktor” në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm” (shtojca 1).*
4. *Kriteret që duhet të plotësojë kandidati, kush mund të aplikojë për programin, kush ka prioritet dhe dokumentacioni për aplikim.*
5. *Modeli i paraqitjes së projekt-propozimit kërkimor të kandidatit për këtë program.*

Në faqen zyrtare të USH-së, rezulton se me Urdhrin e Rektorit nr. 86, datë 14. 11.2022 është kryer hapja e aplikimeve në programin “Doktoratë” në Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm”, me afat nga data 14.11.2022 deri me datë 24.12.2022. Me shkresën nr. 3544/1, datë 16.11.2022 janë caktuar fushat e studimit:

- a. Shkenca shoqërore
- b. Shkenca humane dhe arte
- c. Shkenca natyrore
- d. Shkenca shëndeti

Me shkresën nr. 3544/2, datë 14.11.2022 është bërë njoftimi i hapjes së pranimeve për këtë program studimi.

Me shkresën nr. 3544/3, datë 14.11.2022 është publikuar dokumentacioni që duhet të përmbajë dosja individuale e aplikimit ku përcakton 13 dokumente.

Me shkresën nr. 3544/4, datë 14.11.2022 janë publikuar kriteret e përgjithshme dhe specifike që duhet të plotësojë kandidati. USH e ka konsideruar si program Doktorate Ndërdisciplinore, dhe për rrjedhojë ka ngritur mekanizma kontrolli/vlerësimi në rang institucioni.

Senati Akademik si organi kolegjal më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij, në vijim të ankesave të aplikantëve lidhur me mënyrën e vlerësimit të dosjeve dhe skualifikimin e tyre nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore Doktor, i Fakultetit Ekonomik, ka miratuar Vendimin nr. 34, datë 23.01.2023 “Për rivlerësimin e procedurës së kritereve të kandidatëve për doktoratën “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm”, nga ana e Komisionit të Përhershëm Institucional”.

Duke qenë se Rektori të USH-së, i janë përcjellë sipas rregullores, konkretisht (shkresa nr. 62, datë 12.01.2023 e Dekanit të Fakultetit Ekonomik, Vendimi nr. 1, datë 10.01.2023 “Mbi kualifikimin fitues të aplikantëve për ndjekjen e programit të studimit Doktoratë në Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm, si dhe Shkresa nr. 63, datë 12.01.2023 e FE-së “Dërgim për publikim e listës paraprake të kandidatëve fitues”, konform kriterit të përgjegjësisë zyrtare lidhur me nënshkrimin dhe publikimin e këtij dokumentacioni si dhe bazuar në nenin 31 të Statutit të USH-së germa d) dhe e) ku përcaktohet se: “Rektori ka të drejtë të shfuqizojë vendimet e dekanit kur ato bien ndesh me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me këtë Statut, me rregulloret e USH-së dhe me vendimet e Senatit. Rektori garanton zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të Statutit dhe të rregulloreve të brendshme të USH-së;”, ka ndërmarrë veprimet për zbatimin e Vendimit të Senatit Akademik nr. 34, datë 23.01.2023 “Për rivlerësimin e procedurës së kritereve të kandidatëve për doktoratën “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm”, nga ana e Komisionit të Përhershëm Institucional”.

E gjithë kjo ndërhyrje dhe procedurë është ndërmarrë nga Senati Akademik dhe Rektori si rrjedhojë e mosrespektimit nga ana e KDHSHD në Fakultetin Ekonomik të kritereve të renditura në seksionin II të shpalljes lidhur me prioritetin e aplikantëve për regjistrimin në doktoratë, ku specifikohej konkretisht se kanë prioritet:

- a) Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Shkodrës dhe Fakulteteve Ekonomike të Universiteteve të tjera publike e jopublike.
- b) Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në Departamentet e Fakulteteve të USH-së me të cilët është lidhur aktmarrëveshja e grupimit të njësive bazë.
- c) Staf akademik me kohë të pjesshme, i Fakultetit Ekonomik të USH-së dhe Universiteteve të tjera kur ai/ajo është punësuar me kohë të plotë në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
- d) Punonjës të institucioneve dhe organizatave publike e jopublike, që përfshihen në kërkim bazë ose të zbatuar, aktiviteti i të cilave lidhet me fushat e kërkimit të Doktoratës.

Kjo është dhe arsyeja se përse Komisioni i Përhershëm Institucional për Dhënien e Gradës Shkencore Doktor ka vendosur të kualifikojë kandidatët A.G, K.P, B.G dhe O.U, të cilët ishin skualifikuar nga Komisioni i FE-së, dhe theksojmë se nuk kanë skualifikuar nga lista e fituesve asnjërin nga kandidatët e përzgjedhur nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore Doktor në FE.

Pas kësaj, me urdhrin e punës të MAS nr. 116, datë 29.03.2023 “Mbi shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve në programin e studimit “Doktoratë” në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm”, është verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacioni mbi aplikimet e regjistrimit të kandidatëve.

Grupi i punës ka konstatuar se Programi i Doktoratës nuk është me karakter ndërdisiplinor, dhe si rrjedhojë është program në fushën e përgjegjësisë së Fakultetit Ekonomik. Gjithashtu ka konsideruar të ngritur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, Komisionin e Përhershëm Institucional për Dhënien e Gradës Shkencore Doktor të ngritur me Vendim Senati Akademik, e për rrjedhojë ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të të gjithë vendimmarrjes së kryer nga ky Komision.

Ky raport është përcjellë pranë FE-së për zbatim dhe janë ndërmarrë veprimet për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga MAS.

Në përfundim të shqyrtimit ka hartuar raportin e kontrollit nr. 1397/5, datë 28.04.2023, protokolluar në institucionin tonë me nr. 1486, datë 02.05.2023, ku ka materializuar konkluzionet e arritura dhe në vijim rekomandimet e lëna për zbatim nga USH.

Së pari, ju bëjmë me dije se ankuesja S.S, është shpallur fituese si nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore Doktor pranë Fakultetit Ekonomik, me Vendimin nr. 1, datë 10.01.2023, “Mbi Kualifikimin fitues të aplikantëve për ndjekjen e programit të studimit, “Doktoratë”, në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm”, ashtu edhe nga Komisioni Institucional për Dhënien e Gradës Shkencore Doktor, i ngritur me Vendimin e Senatit Akademik nr. 263, datë 19.12.2022,

fakt ky i cituar edhe nga Grupi i MAS, në raportet e kontrollit nr. 1397/5, datë 28.04.2023, dhe raportin përfundimtar me nr. 1397/8, datë 06.07.2023.

Ky fakt hedh poshtë çdo pretendim të ankueses për diskriminim nga Komisioni Institucional për Dhënien e Gradës Shkencore Doktor, i ngritur me Vendimin e Senatit Akademik nr. 263, datë 19.12.2022, pjesë e të cilit ka qenë dhe Rektorja, ndaj të cilës ankuesja tenton të hedhë akuza për diskriminim. Po ashtu diskriminim ndaj ankueses nuk ka patur as nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore Doktor pranë Fakultetit Ekonomik.

Është MAS organi kompetent që ka shqyrtuar ligjshmërinë e procedurës konform legjislacionit në fuqi, ku në vijim grupi i punës është shprehur për kriteret e të gjithë kandidatëve aplikantë, ku ndër të tjera edhe për ankuesen S.S, në faqen 9 të raportit shprehet si vijon:

Në dosjen e kandidatës rezulton Dëshmi e gjuhës së huaj e mbrojtur në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, jo në përputhje me kriterin 1/C të miratuar nga njësia bazë (Fakulteti Ekonomik). Gjithashtu nuk rezulton që për vitin akademik 2022-2023 të jetë angazhuar si personel akademik me kohë të plotë/pjesëshe në IAL, pavarësisht se është propozuar nga departamenti përkatës për riangazhim në mësimdhënie për vitin akademik 2022-2023. Shpallur fitues si nga Komisioni i FE, dhe nga Komisioni i Përhershëm Institucional.

Grupi i punës pasi ka marrë në shqyrtim observacionet e USH-së, të përcjella me shkresën nr. 1486/1, datë 19.05.2023 ka evidentuar se:

Komisioni për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, i ngritur pranë FE duhet ti respektojë kriteret e miratuara prej tyre, gjatë përzgjedhjes së kandidatëve, siç është evidentuar më sipër, duke respektuar kriterin e gjuhës sipas nivelit të përcaktuar në kuadrin ligjor në fuqi, në kohën e shpalljes së kriteve.

MAS në Raportin përfundimtar nr. 1397/8, datë 06.07.2023, ka lënë për zbatim rekomandimet si më poshtë:

1. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, duke konsideruar të gjitha gjetjet e grupit të punës, të marrë masa për rishqyrtimin e aplikimeve nga komisioni për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, i ngritur pranë FE në USH sipas kriteve të shpallura dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi brenda datës 26.07.2023”.

Pas zbatimit të rekomandimeve të sipërcituara të MAS, me shkresën nr. 1397/15, datë 28.09.2023 protokolluar në rektorat me nr. 1486/7, datë 29.09.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në konstatimet e tij përcakton si më poshtë: “Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, përkatësisht Komisioni i Dhënies së Gradës “Doktor” pranë FE, ka rishqyrtuar aplikimet për pranim në programin e Doktoratës në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm” sipas kriteve të shpallura nga vetë IAL dhe rezultatet e shpallura janë në përputhje edhe me konstatimet e grupit të punës të përcjella me raportin përkatës me nr. 1397/1, datë 06.07.2023.

Kandidatët e vlerësuar pozitivisht për pranim në programin e sipërpërmendur plotësojnë të gjitha kriteret për pranim siç përcaktohet në aktet në fuqi dhe kriteret e shpallura nga IAL”.

Ankesa e depozituar për trajtim pranë KMD-së nuk gjen mbështetje në Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, pasi siç provohet ankuesja S.S nuk provon që është diskriminuar sipas parashikimeve të këtij ligji.

Kriteri i vendosur nga FE për pranim në programin e studimit “Doktoratë” në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm” në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”: “Të ketë dëshmi të zotërimit të njëres prej gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht në nivel C1. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi, të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri”, është kërkesë ligjore e detyrueshme për zbatim sipas përcaktimit të Udhëzimit nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”.

Pretendimi i ankueses se Udhëzimi i mësipërm i cili përcakton nivelin e gjuhës së huaj është ndryshuar nga MAS me Udhëzimin nr. 10, datë 16.06.2023, duke ulur kriterin nga C1 në nivelin B2, nuk ka efekte prapavepruese për kohën kur janë kryer shpalljet e pranimeve në doktoratë dhe përzgjedhjet e kandidateve për vitin akademik 2022-2023.

Siç shihet në konstatimin e MAS, Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, i ngritur pranë FE si dhe Komisioni i Përhershëm Institucional e kanë shpallur fituese ankuesen S.S çka hedh poshtë në mënyrë të pakundërshtueshme pretendimin se nuk është firmosur kontrata me qëllim diskriminimi nga ana e Rektores së USH-së, ndaj të cilës ankuesja tenton të hedhë akuza për diskriminim. Për analogji, edhe nëse ankuesja do kishte qenë pjesë e personelit akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2022-2023, sërish do ishte skualifikuar nga lista fituese e kandidatëve për doktoratë, për shkak të mosplotësimit të kriterit të Gjuhës së Huaj, njëlloj si aplikantë të tjerë që janë skualifikuar për shkak të mosplotësimit të këtij kriteri të vetëm. (Siç provohet nga raporti i MAS).

Parashtrimet e ankueses janë në kundërshtim me faktet, pasi nga njëra anë ankuesja shprehet se Komisioni i Përhershëm Institucional drejtohej nga Rektorja e cila me qëllim nuk ka firmosur kontratën si pedagoge e jashtme për ta diskriminuar, kur faktet tregojnë se ajo është shpallur fituese nga Komisioni i Përhershëm Institucional, i cili drejtohej nga Rektorja.

Siç provohet, është grupi i punës i ngritur nga MAS që ka konstatuar kualifikimin e saj nga të dyja Komisionet si në kundërshtim me kriteret ligjore e specifike për tu pranuar në programin e doktoratës, dhe si organi kompetent për kontrollin e ligjshmërisë së IAL-ve ka lënë rekomandimet përkatëse.

Kriteret e doktoratës përcaktohen në VKM-në nr. 112, datë 23.02.2018. Në këtë VKM përcaktohet se kriteret specifike përcaktohen në rregulloren e njësive bazë, siç është rasti i rregullores së FE-së për doktoratën. Kriteri i gjuhës së huaj përcaktohet në Udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.

USH ka zbatuar këto rekomandime jo vetëm për ankuesen por për të gjithë aplikantët. Në interpretim të sa më sipër, rezulton se nga Universiteti i Shkodrës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim apo akt diskriminues, pasi nga të dy komisionet e ngritura nga Universiteti i Shkodrës, S.S është shpallur fituese.

Grupi i punës i MAS ka konstatuar kualifikimin e ankueses në listën fituese si të kryer në kundërshtim me kriteret ligjore e specifike si nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore Doktor pranë FE ashtu edhe nga Komisioni i Përhershëm Institucional, për arsye të mosplotësisimit të kriterëve. Kualifikimi i kandidatëve i kryer nga komisionet e sipërcituara, është konstatuar nga MAS i kryer në kundërshtim me kriteret ligjore e specifike, jo vetëm për ankuesen S.S por edhe për kandidatë të tjerë siç verifikohet qartë nga Raporti i MAS, bashkëngjitur këtyre parashtrimeve”.

Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 1397/19, datë 01.11.2023, dërgoi kopje të raportit nr. 1397/7, datë 06.07.2023 “Raport mbi shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve në programin e studimit “Doktoratë” në “Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm” në Universitetin e Shkodrës”.

Në përgjigje të parashtrimeve të Universitetit të Shkodrës, ankuesja me e-mail-in datë 16.11.2023, parashtoi se: “1) Në materialin e dërguar mungojnë informacione dhe shkresa zyrtare të cilat spostojnë vëmendjen e veprimit. Në detaje mungojnë: a) Vendimi i shfuqizimit të vendimit të komisionit të doktoraturës të fakultetit ekonomik - nuk gjendet dhe nuk është marrë asnjëherë vendim. b) Vendimi i senatit akademik për moskonsiderimin e gjuhës së huaj si kriter hyrës në programet studimore - por vetëm si kriter dalës. Kjo ka shumë rëndësi sepse ndryshe nga universitetet publike dhe private të cilat realizojnë teste të gjuhës së huaj çdo 2 javë dhe japin afat aplikimi në doktoraturë për 1 muaj, në USH janë lënë vetëm 2 javë afat për aplikim dhe asnjë datë provimi e publikuar sipas vendimit të MAS. c) Mungojnë në shkresa vendimi i senatit akademik për mospagesën e tarifës së doktoratës për pedagogët e brendshëm. d) Mungon vendimi i senatit akademik datë 23.01.2023 sipas të cilit duhen rishikuar vendimet e komisionit të doktoratës për të favorizuar pedagogët e brendshëm dhe këtë e gjeni në aneksin 7 - emaili i rektores aktuale e cila e komenton në senatin akademik dhe kërkon menjëherë marrjen e masave për të ndryshuar vendimin. Në prapësimet e palës del sikur rektorja nuk ka bërë asnjë shkëlqje por mjafton leximi i emailit në aneksin 7 që ka shkruar për heqjen e tyre dhe i ka hequr kur është futur në komision! e) Mungojnë dokumentat pse nuk janë nënshkruar kontratat e pedagogëve të

jashtëm për fakultetin ekonomik nga rektorja edhe pse kanë qenë të firmosura nga departamenti dhe fakulteti - aneksi 16. Në fakultet e tjera kontratat janë firmosur në kohë dhe për një aplikues doktore i cili ishte përjashtuar nga komisioni i doktoratës i fakultetit i është firmosur kontrata si i jashtëm nga rektorja dhe është shpallur fitues nga komisioni i rektores. f) Në aneksin 10 gjeni shkresën e miratuar nga dekania e fakultetit ekonomik ku lajmërohen se studentët janë të çregjistruar. Vendimi i çregjistrimit dhe i përjashtimit është marrë nga MAS e cila ka çregjistruar numrat e matricullimit të studentëve. Komisioni i doktoratës është mbledhur vetëm formalisht në ditë zyrtar dhe ka marrë vendimin e përjashtimit nr. 1, 16 dhe 17 duke shkruar edhe motivin zyrtar - na ka detyruar ministria. Ditën e nesërme ka ardhur grupi i kontrollit dhe i ka detyruar nëpërmjet rektores të ndryshojnë aktin 16 dhe 17 duke hequr vetëm pjesën në të cilën i ka detyruar MAS”.

Me shkresën me nr. 1397/19, datë 01.11.2023, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka dërguar kopje të raportit objekt shqyrtimi me nr. 1397/7, datë 06.07.2023.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 1048/5, datë 22.12.2023 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 10.01.2024, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces, si dhe kërkoi kopje të dokumentacionit si më poshtë:
 - Kopje të ankesës për diskriminim të bërë nga S.S me shkresën nr. 1142, datë 06.09.2023, drejtuar Fakultetit Ekonomik, Komisionit të Dhënies së Gradës Shkencore Doktor dhe të procedurës së ndjekur për trajtimin e kësaj ankese dhe përgjigjes së dhënë.
 - Informacion nëse dhe në fakultete të tjera të universitetit ka ndodhur procesi i rivlerësimit të kandidatëve fitues në programin e doktoratës.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 10.01.2024, me praninë e të dy palëve në proces: subjekti ankues e përfaqësuar nga bashkëshorti i saj z. P.S dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësueses me autorizim nr. 18, datë 09.01.2024, të Universitetit të Shkodrës, znj. J.T.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohen në vijim, gjatë arsytimit të vendimit.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohen në vijim.

Në vijim të seancës dëgjimore, Universiteti i Shkodrës me shkresën nr. 18/1, datë 22.01.2024, në mes të tjerash informoi Komisionerin si më poshtë: *“Skualifikimi i znj. S.S nga programi i doktoratës nuk është bërë nga strukturat e Universitetit të Shkodrës, por nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, vërtetuar kjo me raportin përfundimtar nr. 1397/8, datë 06.07.2023. Siç shihet në këtë raport, rezulton se MAS me Urdhrin nr. 159, datë 29.03.2023, ka ngritur një grup pune “Për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve në programin e studimit “Dokoratë” në “Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm” në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.*

Siç rezulton në këtë raport, grupi i punës ka verifikuar dosjet e 36 aplikantëve dhe ka dalë në konkluzione për secilin prej tyre në lidhje me plotësimin apo jo të kriterëve të miratuara sipas legjislacionit në fuqi.

Nga këto verifikime ka rezultuar se në dosjen e ankueses S.S rezulton dëshmi e Gjuhës së Huaj e mbrojtur në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, jo në përputhje me kriterin I/C të miratuar nga njësia bazë (Fakulteti Ekonomik). Gjithashtu, nuk rezulton se për vitin 2022-2023 të jetë e angazhuar si personel me kohë të plotë/pjesëshme në IAL... “Shpallur fitues si nga Komisioni në Njësinë kryesore dhe nga Komisioni i Përhershëm Institucional”.

Siç shihet qartë në raportin e MAS, ka aplikantë të cilët për shkak të mosplotësimit të një kriteri të vetëm janë skualifikuar nga programi i doktoratës”.

Në vijim përfaqësuesi i ankueses me e-mail-in datë 06.02.2024 në mes të tjerash ka informuar dhe për shtesë në subjektet të cilat pretendohet se kanë kryer diskriminim, si më poshtë: *“Në lidhje me pretendimet e Universitetit se është MAS që ka marrë vendimin direkt të përjashtimit, kërkoj që të shtohet dhe MAS si subjekt që mund të ketë shkaktuar sjelljen diskriminuese”.*

Në vijim, përfaqësuesi i ankueses me e-mail-et datë 14.02.2024, 19.02.2024 dhe 14.03.2024 ka dërguar informacion dhe dokumentacion në mbështetje të pretendimeve të saja.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e

subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Komisioneri vlerëson të theksojë se, pretendimi i ngritur nga subjekti ankues, pas seancës dëgjimore, lidhur me shtimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si subjekt që mund të ketë shkaktuar sjellje diskriminuese ndaj saj, është pretendim i ri që nuk lidhen me objektin fillestar të ankueses së regjistruar pranë KMD-së, me datë 26.09.2023.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të subjektit ankues, (depozituara në ankesën me nr. 189, datë 26.09.2023, pranë KMD-së) Komisioneri vlerëson se objekt i gjykimit e analizës të kësaj vendimmarrje, janë bërë vetëm ato pretendime mbi bazën e të cilave janë investuar palët gjatë shqyrtimit të ankesës, dhe për e mbi të cilat ka vijuar procedura hetimore, kundrejt subjektit për të cilin ka pretenduar se e ka diskriminuar Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se të gjitha pretendimet që nuk janë objekt i ankesës fillestare, nuk janë objekt i analizës së këtij vendimi dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohen gjykimit të tij.

Subjekti ankues në ankesën objekt shqyrtimi ka pretenduar diskriminim nga ana e Universitetit të Shkodrës për skualifikimin nga programi i doktoratës për shkak të mungesës së kontratës si pedagoge e jashtme si dhe certifikatës së gjuhës së huaj.

Gjithashtu S.S, me ankesën nr. 234, datë 27.10.2023, ka pretenduar diskriminim nga ana e Universitetit të Shkodrës, për shkak të *“shtatzënisë”*, *“gjendjes familjare”* dhe për *“çdo shkak tjetër”*, lidhur me mosfirmosjen e kontratës si pedagoge e jashtme, për vitin akademik 2022-2023.

Në këto kushte, lidhur me pretendimin e ankueses për mosfirmosjen/mungesën e kontratës si pedagoge e jashtme për vitin akademik 2022-2023, Komisioneri vlerëson se do të shprehet në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 234, datë 27.10.2023.

Në ankesën objekt shqyrtimi, Komisioneri do të shqyrtojë pretendimin e ankueses lidhur me skualifikimin nga programi i doktoraturës për shkak të mosplotësimit të kriterit të gjuhës së huaj.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Referuar dokumentacionit kryesor të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) me Urdhër nr. 174, datë 04.04.2022 “Për hapjen e programit të Studimit të ciklit të tretë “Dokoratë” në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm” në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër (USH), ka licencuar hapjen e programit të ciklit të tretë të studimeve në ekonomi dhe turizëm të qëndrueshëm.

Senati Akademik i USH-së me Vendimin nr. 116, datë 31.05.2022 ka miratuar rregulloren “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratës ndërdisiplinore në Universitetin e Shkodrës”. Në nenin 6/1/ç të kësaj Rregulloreje është përcaktuar se: “6.1. Për të kryer aplikimin në programet e studimit të doktoratës, aplikanti duhet të plotësojë këto kriteret: ç) të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar”.

Me shkresën nr. 1202, datë 05.10.2022 “Mbi miratimin e kriterëve të pranimit në programin “Dokoratë” në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm” Fakulteti Ekonomik i USH ka dërguar pranë Rektorit të Universitetit kriteret e pranimit në këtë program.

Me Vendimin nr. 33, datë 05.10.2022, Dekanati i Fakultetit Ekonomik të USH-së ka miratuar kriteret e pranimit në programin “Dokoratë” në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm”. Në pikën 1/c të këtij vendimi është vendosur se: “1. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për tu përfshirë në programin “Dokoratë në Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm”, si më poshtë: a. b. c. Të ketë dëshmi të zotërimit të njëjës prej gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht, në nivel C1. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri”.

Universiteti i Shkodrës me shkresën nr. 3544/2, datë 14.11.2022 ka bërë njoftimin e hapjes së pranimeve në ciklin e tretë në “Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm” (20 kuota) dhe aplikimet do të kryhen nga data 14.11.2022 deri më datë 24.12.2022.

Universiteti i Shkodrës me shkresën nr. 3544/4, datë 14.11.2022, ka publikuar kriteret e përgjithshme dhe specifike që duhet të plotësojë kandidati, e cila në pikën 1/c ka përcaktuar kriterin për gjuhën e huaj: “c. Të ketë dëshmi të zotërimit të njëjës prej gjuhëve të huaja të

Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht, në nivel C1. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri”.

Senati i Universitetit të Shkodrës me Vendimin nr. 263, datë 19.12.2022 ka miratuar krijimin e Komisionit të përhershëm institucional për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.

Fakulteti Ekonomik me shkresën nr. 63, datë 12.01.2023, ka dërguar për publikim pranë Rektorit të USH-së, listën e aplikuesve fitues për ndjekjen e programit të ciklit të tretë të studimeve në “*Ekonomi dhe turizëm të qëndrueshëm*” sipas listës nr. 1 të Vendimit nr. 1, datë 10.01.2023 të Komisionit të Dhënies të Gradës Shkencore Doktor (KDHGSHD). Në këtë listë janë shpallur 20 aplikantë fitues, përfshirë dhe S.S.

Me Vendimin nr. 1, datë 10.01.2023, KDHGSHD i Fakultetit Ekonomik, nga 52 aplikues ka kualifikuar fitues 36 aplikantë dhe ka skualifikuar 16 aplikantë.

Senati Akademik i USH-së me Vendimin nr. 34, datë 23.01.2023 “*Për rivlerësimin e procedurës së vlerësimit të kriterëve të kandidatëve për doktoraturën në “Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm”*”, ka vendosur të rivlerësojë nga Komisioni i përhershëm institucional për dhënien e gradës shkencore “Doktor” të gjithë procedurën e ndjekur dhe listën e kandidatëve aplikues.

Komisioni i përhershëm institucional për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, me Vendimin nr. 77, datë 13.03.2023, ka vendosur miratimin e listës përfundimtare të kandidatëve fitues në doktoratë “*Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm*”. Në këtë listë S.S rezulton përsëri fituese.

Me shkresën nr. 578, datë 21.03.2023, Fakulteti Ekonomik ka publikuar listën e 20 studentëve të regjistruar përfundimisht në ciklin e tretë të studimeve në doktoratë në “*Ekonomi dhe turizëm të qëndrueshëm*”.

Lidhur me procesin e rivlerësimit nga Komisioni i përhershëm institucional për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, ka pasur ankesa drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Sekretari i Përgjithshëm i MAS me Urdhrin nr. 159, datë 29.03.2023, ka ngritur grupin e punës për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve në programin e studimit “Doktoratë” në “*Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm*”, në USH.

Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 1397/5, datë 28.04.2023, ka dërguar pranë USH-së raportin paraprak mbi gjetjet dhe konstatimet, sipas objektit të verifikimit. Në këtë raport, në mes të tjerash grupi i punës ka konstatuar se: “Kandidati 18. S.S. Në dosjen e kandidatës rezulton Dëshmi e gjuhës së huaj e mbrojtur në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, jo në përputhje me kriterin I/C të miratuar nga njësia bazë (Fakulteti Ekonomik). Gjithashtu, nuk rezulton që për vitin 2022-2023 të jetë angazhuar si personel akademik me kohë të plotë/pjesshme në IAL,

pavarësisht se është propozuar nga departamenti përkatës për riangazhim në mësimdhënie për vitin akademik 2022-2023. Shpallur fituese si nga Komisioni në njësinë kryesore dhe nga Komisioni i Përhershëm Institucional”.

Në konkluzionet e këtij raporti në pikën pesë, është shprehur se: *“Së pesti, në lidhje me kriterin I/C, rezulton se në disa raste nuk janë respektuar parashikimet e Udhëzimit nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, përsa i përket nivelit të njohjes së gjuhës së huaj dhe llojit të certifikatës së pranuar të lëshuar nga subjekte të njohura nga MAS, për ofrimin e testeve ndërkombëtare”*.

Universiteti i Shkodrës me shkresën nr. 1486/1, datë 19.05.2023, ka dërguar në MAS, observacionet e saj lidhur me raportin paraprak.

Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 1397/7, datë 06.07.2023, ka dërguar pranë USH-së raportin përfundimtar mbi shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve në programin e studimit “Doktoratë” në “*Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm*”. Në këtë raport, në mes të tjerash grupi i punës ka konstatuar përsëri se: *“Kandidati 18. S.S. Në dosjen e kandidatës rezulton Dëshmi e gjuhës së huaj e mbrojtur në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, jo në përputhje me kriterin I/C të miratuar nga njësia bazë (Fakulteti Ekonomik). Gjithashtu, nuk rezulton që për vitin 2022-2023 të jetë angazhuar si personel akademik me kohë të plotë/pjesëshe në IAL, pavarësisht se është propozuar nga departamenti përkatës për riangazhim në mësimdhënie për vitin akademik 2022-2023. Shpallur fituese si nga Komisioni në njësinë kryesore dhe nga Komisioni i Përhershëm Institucional”*.

Në konkluzionet e këtij raporti në pikën pesë, është shprehur se: *“Së pesti, në lidhje me kriterin I/C, rezulton se në disa raste nuk janë respektuar parashikimet e Udhëzimit nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, përsa i përket nivelit të njohjes së gjuhës së huaj dhe llojit të certifikatës së pranuar të lëshuar nga subjekte të njohura nga MAS, për ofrimin e testeve ndërkombëtare”*.

Në përfundim të raportit, grupi i punës i MAS, në mes të tjerash ka rekomanduar:

1. Universiteti i Shkodrës, duke konsideruar të gjitha gjetjet e grupit të punës, të marrë masa për rishqyrtimin e aplikimeve nga KDHGSHD, i ngritur pranë FE në USH sipas kriterëve të shpallura dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi, brenda datës 26.07.2023.

Fakulteti Ekonomik me Vendimin nr. 13, datë 30.08.2023 *“Mbi kualifikimin fitues të aplikantëve për ndjekjen e programit të studimit doktoratë në “Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm” nga*

shqyrtimi i dosjeve të aplikantëve” ka shpallur jo fitues S.S për shkak se: “Nuk plotësohet kriteri I/C për gjuhën e huaj dhe kriteri II/A për angazhimin në momentin aktual të aplikimit si personel akademik apo kërkimor, sipas vendimit të FE me nr. 33, datë 05.10.2022, me nr. 1201, për kriteret e pranimit në këtë Doktoratë”.

Fakulteti Ekonomik me Vendimin nr. 16, datë 13.09.2023 “Mbi ankimimet për skualifikim të aplikimit të kandidatëve për pranim në programin e studimit doktoratë në Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm”, ka vendosur të mosndryshojë Vendimin nr. 13 të KDHGSHD i datës 30.08.2023, për aplikanten S.S.

Rektori i USH-së me shkresën nr. 2667/1, datë 18.09.2023, drejtuar FE, ka kërkuar që të rishikohet procedura e rishqyrtimit të aplikimeve nga KDHGSHD, sipas rekomandimit të MAS.

Fakulteti Ekonomik me Vendimin nr. 18, datë 20.09.2023 “Mbi revokimin e vendimeve nr. 16 dhe nr. 17, datë 13.09.2023 të KDHGSHD së FE dhe rishqyrtimin e dosjeve të aplikuesve në programin e doktoratës në Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm, me kërkesë të Rektores së USH të paraqitur me shkresën nr. 2667/1, datë 18.09.2023”, ka vendosur të mosndryshojë Vendimin nr. 13, datë 30.08.2023, të KDHGSHD të FE, lidhur me listën e aplikantëve jofitues për ndjekjen për vitin akademik 2022-2023 të doktoratës në Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm, pas rishqyrtimit të ankimimit të: “a. Aplikantes S.S, pasi nuk plotëson kriteri I/C dhe kriteri II/A të kriterëve të pranimit në programin e doktoratës në Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm, sipas Vendimit të FE me nr. 33, datë 05.10.2022, siç është referuar edhe në gjetjet e MAS të shprehura në raportin përfundimtar në lidhje me procesin e aplikimit dhe regjistrimit në programin e doktoratës në Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm, me nr. 1397/8, datë 06.07.2023”. Me vendimin e mësipërm FE ka shpallur 10 aplikantë fitues për ndjekjen e programit të ciklit të tretë të studimeve Doktoratë në “Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm”.

Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 1397/15, datë 28.09.2023, drejtuar USH-së, në mes të tjerash ka konstatuar se: “Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, përkatësisht Komisioni i Dhënies së Gradës “Doktor” pranë FE, ka rishqyrtuar aplikimet për pranim në programin e Doktoratës në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm” sipas kriterëve të shpallura nga vetë IAL dhe rezultatet e shpallura janë në përputhje edhe me konstatimet e grupit të punës të përcjella me raportin përkatës me nr. 1397/1, datë 06.07.2023. Kandidatët e vlerësuar pozitivisht për pranim në programin e sipërpërmendur plotësojnë të gjitha kriteret për pranim siç përcaktohet në aktet në fuqi dhe kriteret e shpallura nga IAL”.

Legjislacioni i zbatueshëm.

Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 78, ka parashikuar se: “1. Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën “Masteri shkencave” ose “Master i arteve” dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga institucioni i arsimit

të lartë. 2. Kriteret e pranimit në programet e ciklit të tretë përcaktohen nga njësitë bazë, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Këto kritere bëhen publike nga IAL-ja dhe i përcillen QSHA-së, si dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin. 3. Kriter pranimit në një program studimi të ciklit të tretë është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri”.

Udhëzimi nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, në pikën 3 ka parashikuar se: “... Për pranimitin në programin e studimeve të ciklit të tretë, kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, të nivelit C1”.

Statuti i Universitetit të Shkodrës i miratuar me Urdhrin e MAS me nr. 366, datë 05.07.2018, në nenin 57 “Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve”, ka parashikuar se: “1. Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën “Master i shkencave” ose “Master i arteve” dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga USH në rregulloren përkatëse. 2. Kriteret e pranimit në programet e ciklit të tretë propozohen nga njësitë që organizon doktoraturën në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe miratohen në Senatit e USH-së. Këto kritere bëhen publike nga USH dhe i përcillen QSHA dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin. 3. Kriter pranimit në një program studimi të ciklit të tretë është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri”.

Me Vendimin nr. 33, datë 05.10.2022, Dekanati i Fakultetit Ekonomik të USH-së ka miratuar kriteret e pranimit në programin “Doktoratë” në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm”. Në pikën 1/c të këtij vendimi është vendosur se: “1. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për tu përfshirë në programin “Doktoratë” në “Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm”, si më poshtë: a. b. c. Të ketë dëshmi të zotërimit të njërës prej gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht, në nivel C1. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri”.

Universiteti i Shkodrës me shkresën nr. 3544/4, datë 14.11.2022, ka publikuar kriteret e përgjithshme dhe specifike që duhet të plotësojë kandidati, e cila në pikën 1/c ka përcaktuar kriterin për gjuhën e huaj: “c. Të ketë dëshmi të zotërimit të njërës prej gjuhëve të huaja të

Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht, në nivel C1. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri”.

Duke analizuar aktet ligjore dhe nënligjore sa më sipër, Komisioneri konstaton se kandidati në momentin kur janë shpallur kriteret për tu përfshirë në programin doktoratës, duhet të ketë dëshmi të zotërimit të njëres prej gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht, në nivel C1.

Rezulton se ankuesja nuk plotëson kriterin e gjuhës së huaj sipas parashikimeve të shpallura nga Universiteti i Shkodrës në kohën kur janë kryer përzgjedhjet e kandidatëve për ciklin e tretë të studimeve, për vitin akademik 2022-2023.

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar rezulton se S.S, është shpallur 1 nga 20 fituesit nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore Doktor pranë Fakultetit Ekonomik, me Vendimin nr. 1, datë 10.01.2023, “Mbi Kualifikimin fitues të aplikantëve për ndjekjen e programit të studimit, “Dokoratë”, në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm”.

Gjithashtu, S.S është shpallur përsëri fituese edhe pas rivlerësimit të kandidatëve nga Komisioni Institucional për Dhënien e Gradës Shkencore Doktor, i ngritur me Vendimin e Senatit Akademik nr. 263, datë 19.12.2022.

Referuar sa më sipër, Komisioneri konstaton se Universiteti i Shkodrës në të dy vlerësimet që ka bërë për aplikantët për programin e studimit në doktoratë, ka shpallur fituese subjektin ankues, duke e marrë të mirëqenë plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj nga ana e saj. Ka qenë grupi i punës i ngritur nga MAS i cili në raportin e datës 06.07.2023, ka konstatuar se kandidatja S.S nuk plotëson kriterin e gjuhës së huaj. Raporti i grupit të punës së MAS përveç ankueses ka gjetur mosplotësimin e kriterit të gjuhës së huaj edhe për shtatë kandidatë të tjerë nga lista prej 20 kandidatësh fitues të shpallur nga Universiteti i Shkodrës.

Referuar sa më sipër, rezulton se vendimi i Universitetit të Shkodrës për të skualifikuar ankuesen dhe disa aplikues të tjerë nga lista fituese për të vazhduar studimet e ciklit të tretë të studimeve është bërë nga Universiteti i Shkodrës pas konstatimit të grupit të punës së MAS për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimmarrjes së Universitetit të Shkodrës dhe pas kërkesës së MAS për zbatimin e rekomandimit të grupit të punës.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme, nga ana e Universitetit të Shkodrës, pasi, gjetjet dhe konstatimet për mosplotësimin e kriterit të gjuhës së huaj dhe skualifikimi i saj nga programi i studimit të ciklit të tretë është bërë pas rekomandimit për zbatimin e ligjshmërisë nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Gjithashtu, grupi i punës i MAS në raportin paraprak dhe përfundimtar të

hartuar ka konstatuar tetë kandidatë që nuk plotësonin kriterin e gjuhës së huaj dhe për të gjithë ato kandidatë ka rekomanduar skualifikimin e tyre.

Për rrjedhojë, në shpjegim të sa më sipër dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues, nisur nga kushtet e rrethanat objektive të rastit të saj, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Universitetit të Shkodrës.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Universitetit të Shkodrës, ardhur për shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

B. Lidhur me mosmarrjen në shqyrtim të pretendimit për diskriminim të bërë nga ankuesja në datë 05.09.2023, drejtuar KDHGSHD të Fakultetit Ekonomik.

Lidhur me sa më lart, evidentohet se:

Ankuesja me shkresën datë 05.09.2023, të protokolluar pranë USH-së me nr. 1142, datë 06.09.2023 “Ankesë në lidhje me Vendimin nr. 13, datë 30.08.2023”, në mes të tjerash ka parashtruar se:

“Kriteret e përcaktuara për përjashtim nuk qëndrojnë dhe janë në kundërshtim me ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe vazhdimi i aplikimit të tyre do të sjellin precedentë të rëndë në të ardhmen!

- 1. Përjashtimi me arsyetimin se kandidati nuk ka pasur kontratën e nënshkruar në momentin e aplikimit është i pavlefshëm sepse unë jam shpallur fituese nga konkursi i shpallur nga departamenti i financë-kontabilitetit në muajin tetor 2022 por kontrata nuk është firmosur për shkaqe që nuk janë në dorën time. Vonesa në fillimin e procesit mësimor ka ndodhur për shkak të protestës së pedagoqeve dhe nga vonesa të shkaktuara nga rektorati i universitetit gjë që ka sjellë nënshkrimin e kontratave në muajin janar 2023. Këto dy shkaqe kanë sjellë mosfirmosjen e kontratës gjë e cila ka sjellë edhe marrjen e lejes zyrtare të lindjes nga ana ime në muajin dhjetor (detyrim ligjor). Për këto arsye shkak i supozuar nuk është i ligjshëm dhe është në kundërshtim flagrant me ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi!*
- 2. Përjashtimi me arsyetimin se kandidati nuk posedon certifikatën e gjuhës nuk qëndron sepse i njëjti kriter është hyrës edhe për studentet e masterit por Senati akademik i universitetit të Shkodrës ka marrë vendim që të pranohet hyrja në master dhe student duhet të marrin certifikatën e gjuhës në momentin kur përfundon diplomën. Kriteret e miratuara nga ana e ministrisë kanë ndryshuar nga MAS gjë e cila nuk është reflektuar nga ana e grupit të kontrollit të MAS dhe nga ana e KDHGSHD. Unë*

posedoj një master ekzekutiv që konsiderohet pjesë e studimeve të doktoratës dhe përjashtimi për shkak të tillë konsiderohet shkak diskriminues”.

Në ankesën e saj drejtuar KDHGSHD të Fakultetit Ekonomik, ankuesja ka ngritur pretendimin se kriteret e përcaktuara për përjashtimin e saj janë në kundërshtim me Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, duke parashtruar dhe arsyet e saj.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 19, shkronja ç)⁵, e tij ka parashikuar se: “Drejtuesi i institucionit arsimor është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv në institucionin përkatës, për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. Masat që merren, ndër të tjera, janë: a) b) c)

ç) trajtimi efektiv i ankesave për diskriminim në institucion, duke shqyrtuar çdo ankim brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij”.

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri gjykon se, Universiteti i Shkodrës, nuk ka zbatuar parashikimet ligjore të LMD-së lidhur me hetimin dhe shqyrtimin *efektiv* të ankesës për diskriminim të ankueses dhe haptazi i ka shkelur ato. Komisioneri vëren se, Universiteti i Shkodrës nuk i është përgjigjur dhe as ka shqyrtuar pretendimin e ankueses për diskriminim.

Në rast se do të kishte ndjekur një procedurë të tillë ligjore të parashikuar shprehimisht në LMD, Universiteti i Shkodrës, duhet të kishte patur në konsideratë njëherësh edhe zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, si një garanci që ankueses duhet t’i ish in krijuar mundësitë që ankesa e saj me pretendim diskriminim, të trajtohej efektivisht dhe ajo të dëgjohej dhe të paraqiste argumentet e provat e saj.

Shkelja e këtij parimi përbën shkelje të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, qëndrim ky i konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 69, dt. 16.10.2000 të saj, ka mbajtur qëndrimin se: “Parimi i kontradiktoritetit lidhet e me të drejtën e palëve për t’u dëgjuar, për t’i bërë të njohur njëra tjetrës mjetet dhe faktet mbi të cilat i mbështesin të gjitha pretendimet e tyre, provat e grumbulluara, referencën e saktë ligjore”.

Në këtë kontekst, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, duhet të kishte marrë masa konkrete dhe efektive për trajtimin e pretendimeve të ankueses, sipas parashikimeve ligjore.

⁵ Detyrat e drejtuesit të institucionit arsimor.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues S.S nga ana e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për shkaqet e pretenduara prej saj.
2. Konstatimin e shkeljes së dispozitës së Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 19, germa ç), nga ana e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër lidhur me mostrajtimin e ankesës për diskriminim të bërë nga S.S.
3. Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, të marrë masa për të parashikuar në rregulloret dhe aktet e saj të brendshme, procedura konkrete për trajtimin e ankesave për diskriminim sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar dhe të marrë masa për trajnimin e organeve përgjegjëse për trajtimin e ankimeve me objekt diskriminimin.
4. Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, brenda 3 muajve nga marrja dijëni për këtë vendim, duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA